Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e autorizimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Gani Nekaj	**24.10.2023**	**07.11.2023**	**2023/0783**

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 12.10.2023, OE "Luigj Kastrati B.I."- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2023/0783, kundër njoftimit për kontratë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë OE "DESHISHKU GB SHPK."- Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "044 - Mirembajtja e rrjetit te kanalizimeve brenda territorit te komunes se Skenderajt" me nr. të prokurimit: "643-23-5477-5-2-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – K.K. SKENDERAJ.Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: PUNË, vlera e parashikuar e kontratë 180,000.00 €.Nëse është e përsëritur ankesa, të shënohet se lidhur me këtë lëndë është nxjerr një vendim i mëparshëm i OSHP - së, më Nr. 2023/0493 i dt:07.09.2023.Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

- Data e njoftimit për kontratë: 30.05.2023
- Afati për dorëzimin e ofertave: 19.06.2023
- Procesverbali i hapjes se ofertave : 19.06.2023
- Njoftimi mbi Vendimin e AK-se dhe Letrat Standarde 29.09.2023
- Kërkesa për Rishqyrtim nga OE ankues: 03.10.2023
- Vendimi ndaj Kërkeses per Rishqyrtim : 06.10.2023

- Ankesa ne OSHP nga OE ankues **:** 12.10.2023

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

I.

Neni 1, Qëllimi, par 1; 2 dhe 3.

Neni 6, Ekonomiciteti dhe Efikasiteti, par 1.

Neni 7, Barazia në trajtim/Jo diskriminimi, par 1,2 dhe 6;

Neni 51, Njoftimi i Kritereve të Përzgjedhjes, par 3;

Neni 59, Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve, par 2 dhe par 4, nen par (ii).

Neni 60, Kriteret për Dhënien e Kontratës, par 1, nen par 1.1

Neni 61, Tenderët Jo-Normalisht të Ulët, par 1, par 2 nen par 2.1;2.2;2.3 dhe 2.4

Neni 72, Dokumentacioni dhe informacioni shtesë, par 1

Neni 108/A, Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve, par 8, nen par 8.4.

Neni 131, Shkeljet e Ligjit nga Autoriteti Kontraktues.

II. Dispozitat e Rregullores nr. 01/2022 të prokurimit publik (në tekstin e mëtejmë do të i referohemi RRPP) dhe atë:

Neni 40, Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve, par 40.2; 40.6; 40.12 dhe 40.13.

Neni 41, Tenderët Jo-normalisht të Ulët, par 41.1; 41.6;41.8 nen par a,b,c,d,e dhe par 41.9 nen par a.

Neni 97, Shkeljet e rënda, par 97.1 nen par (d), (h) dhe (o).

III. Mos respektim të vendimit të OSHP-se, PSH nr. 2023/0493

Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Vendimin e AK për refuzim të Kërkesës për Ri-shqyrtim të dt. 06.10.2023;

Arsyetimi i AK nuk është përmbajtjesor, nuk ka ofruar kundër argumente lidhur me pretendimet tona, të sqaruara edhe në kërkesën për rishqyrtim, por ne mënyre diskriminuese, tendencioze dhe ne kundërshtim me nenin 108/A par 8, nen par 8.4 refuzon kërkesën pa i shqyrtuar siç duhet pretendimet tona, madje e kundërshtim edhe me vendimin e OSHP-se, nr.PSH 2023/0493, prandaj, me te drejte e kundërshtojmë vendimin e AK për refuzim të kërkesës për rishqyrtim sepse është nxjerrë në shkelje të Ligjit dhe jo ne argumentim të provave dhe, në tërësinë e tije Vendimi është i pa drejte, tendencioz, dhe diskriminues ndaj kompanisë tonë, sepse , arsyetimi i AK për eliminimin e kompanisë tonë nga aktiviteti i mëtejme i prokurimit, nuk është në përputhje kriteret e përzgjedhjes dhe kriteret e vlerësimit, për faktin se jemi të përgjegjshëm sipas kritereve të përzgjedhjes dhe kemi ofruar çmimin në përputhje me çmimet e tregut në përputhje edhe me kërkesën e AK të paraparë në paramasë citojmë: *Operatorët Ekonomik me Çmime Jo-normalisht të ulët do të eliminohen automatikisht gjatë procesit të vlerësimit të ofertave [.....]*

Provë 1: Kërkesa për rishqyrtim e datë 03.10.2023

Provë 2: Vendimi i AK për refuzim të kërkesës për rishqyrtim i datës 06.10.2023

Pra, AK me ketë vendim vërteton edhe një herë tendencën e qëllimshme për eliminimin e ofertës tonë nga aktiviteti i mëtejme i prokurimit, sepse ne kërkesën për rishqyrtim kemi paraqitur prova dhe argumente të cilat kanë qenë pjese dosës së tenderit me rastin e dorëzimit të tenderit, prandaj është i pa pranueshëm vendimi i AK, sepse është i qëllimshëm dhe ne shkelje të Ligjit.

E para: AK në vendim arsyetohet si ne vijim:

- **Ju si Operatori ekonomik me oferten tuaj me çmimin më të larë**, ju sqarojme se oferta e juaj eshte administrativisht e papergjegjshme, ju keni deshtuar te permbushnii kerkesen e Autoritetit Kontraktues *III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional:* ***pika b)*** *1 (nje) inxhinier i diplomuar apo master drejtimi Infrastruktur Rrugore, me se paku 5 vite pervoje pune profesionale pas diplomimit.* **Ndersa, inxhineri i prezentuar ne oferten tuaj per Infrastruktur Rrugore, Faton Kastrati, ka diplomuar me date: 13.06.2018 dhe nuk e ploteson pervojen e punes prej min. 5 viteve pas diplomit, sepse pervoja e punes pas diplomit ne CV e tij, shenon nga data:01. Shkurt 2021-Prezent, qe i bie 2 vite e 2 muaj pervoje pune profesionale si inxhinier i diplomuar per Infrastrukture Rrugore.** Prandaj bazuar ne nenin 10.1 Udhezuesit Nr-001/2023 per prokurimin publik, shenon shume kjarte, citoje:

CV-ja e dorëzuar nuk përmbush kërkesat	**Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm**

Pra, arsyetimi i AK edhe me ketë vendim, është i pa drejtë, tendencioz dhe në shkelje të dispozitave të LPP-se, sepse inxhinieri në fjalë e ka përvojën mbi 5 vite, kurse po ti referohemi edhe kohës pas diplomimit nen titullim Master, mund të vërtetohet se i nijeti ketë titull e ka fituar me 13.06.2018, kurse hapja e ofertave ka qene 19.06.2023, që dëshmon katërçipërisht se inxhineri në fjalë i plotëson në tersi kërkesat e përzgjedhjes në NJK dhe DT, ku ne rastin konkret ka përvoje mbi 5 vite.

Provë 3: CV-ja, e ing. Faton Kastrati!

Në këtë rast, arsyetimi është i pa drejtë, në kundërshtim me kriteret e përzgjedhjes të parapara në NJK dhe DT dhe, rrjedhimisht është i pa pranueshëm dhe në shekeje të dispozitave të nenit 7, par 1,2 dhe 6, sepse nuk e ekzaminon ofertën tone ne mënyre te barabartë, madje, i shtrembëron faktet që janë prezantuar qartë në CV!

Për me tepër, ne mënyre gabuar dhe jo të drejtë i referohet edhe nenit 10.1 të Udhëzuesit, nr.001-2023, sepse udhëzuesi në fjalë i parasheh shembujt nga rasti i paraqitur ne AK, se si duhet të veproj për të kërkuar informata sqaruese në përputhje me nenin 72 dhe nenin 59 të LPP-së dhe, ku udhëzuesi qartazi i sqaron tri situata, sa i përket dokumentit të CV-së, si në vijim:

CV-ja e dorëzuar nuk përmbush kërkesat	Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm	69
CV-ja e kërkuar nuk është dorëzuar	Mund të kërkohen informata sqaruese	69
CV-ja e dorëzuar nuk përmban informatat e kërkuara, AK nuk mund të vendos	Mund të kërkohen informata sqaruese	69

Pra, AK qëllimisht i shtrembëron faktet, sepse ne këtë rast, për deri sa inxhineri në fjalë është i fushës së kërkuar nga AK dhe me përvoje, atëherë, ne rast se AK nuk e ka të qartë apo CV-ja e tij nuk përmban informatat e kërkuara, mund të kërkoj informata sqaruese bazuar në nenit 72 dhe 59 të LPP-se, ngase këtë e lejojnë dispozitat e LPP-se, prandaj janë shkelje të dispozitave të lartë cekura nga ana e AK, sepse ka diskriminimi dhe trajtim të pa barabartë ndaj kompanisë tonë.

Prandaj, arsyetimi i AK për këtë pikë, është i pa qëndrueshëm dhe në shkelje të dispozitave të lartë cekura.

E dyta: AK në vendim arsyetohet si ne vijim:

- Poashtu, **Ju si Operatori ekonomik me oferten tuaj me çmimin më të lartë**, oferta e juaj eshte administrativisht e papergjegjshme, për faktin se ju keni deshtuar te permbushnii kerkesen e Autoritetit Kontraktues *111.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional:* ***pika c)*** *1 (një) inxhinier i diplomuar apo master drejtimi Gjeodezisë i licencuar me licensë vaide me së paku 5 vite përvojë pune profesionale pas diplomimit.* **Inxhinierit të Gjeodezisë i prezantuar në ofertën tuaj, Fidan Hasaj, i mungon Licensa e Gjeodetit.**

Arsyetimi i AK, është i pa drejtë, tendencioz dhe në shkelje të dispozitave të nenit 59, par 2 dhe nenit 72, par 1 të LPP-se, sepse nëse i referohemi CV-se, te inxhinierit në fjalë, vërtetohet se inxhinieri Fidan Hasaj, posedon licencën e Gjeodetit që nga viti 2011.

Provë 4: CV-ja, Fidan Hasaj!

Pra, AK në mbështetje të nenit 59, par 2 ka mundur të kërkoj informata sqaruese për të siguruar dëshminë e Licencës se Gjeodetit, sepse ky dokument lëshohet nga institucionet e Kosovës, ngase ekzistenca e këtij dokumenti është e fiksuar që nga viti 2011 dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive.

Prandaj, është i pranueshëm dhe i pa qëndrueshme arsyetimi i AK në këtë pike, madje është diskriminues dhe tendencioz ndaj kompanisë tonë.

E treta: AK në vendim arsyetohet si ne vijim:

Tutje, **Ju si Operatori ekonomik me oferten tuaj me çmimin me të lartë**, oferta e juaj eshte administrativisht e papergjegjshme, për faktin se ju keni deshtuar te permbushni kerkesen e Autoritetit Kontraktues *111.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional:* ***pika*** **d)** 1 (një) inxhinier i diplomuar ose master, drejtimi Mbrojtje e Mjedisit, me së paku 5 vite përvojë pune profesionale pas diplomimit. **Inxhinieri i prezentuar në ofertën tuaj, Vehbi Spahiu, nuk e ka të në nënshkruar fare CV- e tij, andaj kjo nuk e përmbush kërkesës sipas NJK dhe FDT te dështmia ku kërkohet citojë: ''**CV-ja e përshkruar qarte me eksperiencën e kërkuar **dhe nënshkruar''**

Arsyetimi i AK, është i pa drejtë, tendencioz, sepse Inxhineri në fjalë është relevant dhe në përputhje me kërkesat e AK, ndërsa sa i përket CV, së tij, ky është një devijim i vogël, sepse edhe dispozitat e nenit 59, par 3 i LPP-se, nen par (ii), i konsideron devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit, madje AK, ka mundësi që përmes kontaktit apo emali adresës të inxhinierit në fjalë, të konstatoj dhe vërtetoj se dokumentet e inxhinierit në fjalë, a janë me dijeninë e tij të paraqitura në këtë tender.

Provë 5: ing. Vehbi Spahiu, email adresa: vebi84@hotmail.com!

Prandaj, janë të pa pranueshme dhe të pa qëndrueshme arsyetimet e AK, ngase janë tendencioze dhe të qëllimshme, ngase të vetmit OE të përgjegjshëm dhe palë me interes për këtë aktivitet jemi ne kompania N.T.SH. "KASTRATI-L" Drenas.

E katërta: AK në vendim arsyetohet si ne vijim:

Tutje, **Ju si Operatori ekonomik me oferten tuaj me çmimin me të lartë,** oferta e juaj eshte administrativisht e papergjegjshme, për faktin se ju keni deshtuar te permbushni kerkesen e Autoritetit Kontraktues: *Aneksin 7 te DT. Operatori Ekonomik duhet te posedoje mjetet, stabilimentet dhe pajisjet teknike që janë te domosdoshme për realizimin e projektit. Paisjet dhe*

Kamion kiper me peshë neto 10-17 tonë	Min. 3 Copë

mekanizimi i obligueshëm sipas tabelës ne Aneksin 7 te DT. Kërkesa:

Kamioni i prezantuar në ofertën tuaj **Kamion Kiper me dy dyer me targa: 01-735-SF-** *Libreza e qarkullimit është* ***me validitet të regjistrimit të skaduar para dorëzimit të ofertave dhe Njoftimit për Kontratë.***

Pra, AK, në kundërshtim me kriteret e përzgjedhjes të parapara në NJK dhe DT, shkel dispozitat e nenit 56.3 të LPP-se, në lidhje me dispozitat e par 40.2, 40.12, dhe 40.13, të nenit 40 të Rregullores nr. 01/2022 për Prokurim Publik, ngase aplikon kritere shtesë të pa parapara në NJK dhe DT, sepse nuk ka kërkuar që të ketë validitet regjistrimi, për me tepër nuk e ekzaminon ofertën tone ne mënyre te drejte, sepse AK ka kërkuar min. 3 Copë, kurse ne kemi ofruar 4 kamion kiper me peshe 10-17 tonë!

Provë 6: Kontrata e marrjes me qira nga kompania "ISEFERI" shpk, Suharekë dhe BAMIRS!

Provë 7: Libreza e kamionit kiper me targa 01-735-SF ne emër të N.T.SH. "KASTRATI-L" Drenas

Prandaj, janë të pa pranueshme dhe të pa qëndrueshme dhe në shkelje të dispozitave të lartë cekura arsyetimet e AK, sepse aplikon kritere të parapara në NJK dhe DT, ngase ne kemi plotësuar kriterin e përzgjedhjes, për me tepër kemi ofruar 4 kamion.

E pesta: AK në vendim arsyetohet si ne vijim:

Përveç të cekurave më lartë, ***Ju si Operatori ekonomik me oferten tuaj me çmimin më të lartë*** *Inxhinieri – drejtimi Hidroteknikë,* ***Ilaz Muhaxheri****, i prezentuar në ofertën tuaj* ***ka mospërputhje të dukshme në nënshkrimin e CV-s së tij dhe nënshkrimi në marrëveshjen për projektin fjalë.***

Operatori Ekonomik **Luigj Kastrati B.I** ne **Kerkesen per Rishqyrtim** te dates 03.10.2023, e pranon se jane dy nenshkrime te ndryshme ndersa njekohesisht munohet ta arsyetoje ne menyre qesharake kinse ''devijim i vogel'' duke u thirrur ne nenin 59, par 3 i LPP-se. ***Mirepo ju kujtojme se kemi te bejme me dy nenshkrime krejtesisht te ndryshme te cilat perveç qe jane te pa pranueshme per AK –Skenderaj, perbejne edhe veper penale.***

Prandaj, meqenese qeshtja eshte mjafte serioze si dhe duke ditur barren dhe pergjegjesine mbi autorsine e nenshkrimit, ky veprim per Autoritetin Kontraktues Komuna e Skenderajt eshte i papranueshme.

Pra, arsyetimi i AK, është i pa drejtë, tendencioz, sepse Inxhineri në fjalë është relevant dhe në përputhje me kërkesat e AK, ndërsa sa i përket CV, së tij, ky është një devijim i vogël, sepse CV-ja e tij, është nen shkruar me dijeninë e tij, sepse edhe dispozitat e nenit 59, par 3 i LPP-se, nen par (ii), i konsideron devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit, madje AK, ka mundësi që përmes kontaktit apo emali adresës të inxhinierit në fjalë, të konstatoj dhe vërtetoj se ky dokument, a është ne dijeninë e tij të paraqitura në ketë tender.

Provë 8: ing. Ilaz Muhaxheri, kontakti: +38349616992.

Për me tepër AK, nëse dyshon në ketë dokument, mund të dërgoj rastin në hetuesi, për konstatimin e gjendjes faktike se a është ne dijeni inxhinieri i lartë cekur dhe, jo të arsyetohet se kinse çështja është mjaft serioze, nëse AK ka dyshime për ketë rast, te lajmëroj rastin ne organet e drejtësisë. Madje, arsyetimi i AK në ketë formë është tendencë për të na frikësuar me te vetmin qëllim që mos të vazhdojmë procesin e ankimimit.

Arsyetimi i AK edhe për ketë pikë është i pa qëndrueshëm dhe ne kundërshtim me dispozitat e nenit 59, par 2 ne lidhje me nenin 72, par 3 i LPP-se, sepse AK, bazuar ne dispozitat e lartë cekura mund te kërkoj informata sqaruese dhe te verifikoj vërtetësinë e dokumentit ne fjalë.

Prandaj, të gjitha pretendimet e AK të lartë cekura, nuk qëndrojnë, janë pa pranueshme, janë tendencioze dhe shkelje të dispozitave të LPP-së.

Kurse, sa i përket vendimit që të mbetet në fuqi vendimi B58 për dhënie të Kontratës OE "DESHISHKU GB" SHPK-PRISHTINË, është tërësisht i pa drejtë, në shkelje të dispozitave të Neni 61, Tenderët Jo-Normalisht të Ulët, par 1, par 2 nen par 2.1;2.2;2.3 dhe 2.4 të LPP-se dhe dispozitat e nenit , Neni 41, Tenderët Jo-normalisht të Ulët, par 41.1; 41.6;41.8 nen par a,b,c,d,e dhe par 41.9 nen par (a) të RrPP, të ne kundërshtim me vet kërkesën e AK ka paraparë në paramase, citojmë: Operatorët Ekonomik me Çmime Jo-normalisht të ulët do të eliminohen automatikisht gjatë procesit të vlerësimit të ofertave [.....] dhe në kundërshtim me vendimin e OSHP-së, nr.PSH 2023/0493

Provë 9: Vendimi i OSHP-se, nr.PSH 2023/0493

Sepse AK, nuk ka mundur të arsyetoj propozimin për dhënie të Kontratës, me as një prove te argumentuar se ka bërë një hulumtim të tregut duke u bazuar në prova dhe fakte të argumentuara, sipas rekomandimit të OSHP-se, ne vendim, por, AK arsyetohet ne rolin e Avokuesit, për OE ri propozuar

për shpërblim me Kontratë OE "DESHISHKU GB" SHPK-PRISHTINË, si ne vijim:

Sa i përket pretendimeve për çmimvee jonormalisht të ulëta, AK- Skenderaj gjatë fazës së rivlerësimit ka zhvilluar komunikimin **Inter partes,** sipas **nenit 41, par 41.2 te RrPP-se nr.001** duke kërkuar sqarime për disa pozicione për çmime jonormalisht të ulëta sipas shkresës së datës: **15.09.2023** dhe për këtë kemi pranuar përgjigjen nga OE **DESHISHKU GB SH.P.K.** me datë: **19.09.2023**, pas shqyrtimit dhe analizimit të përgjigjeve nga komisioni I rivleresimit kemi konstatuar se pergjigjet sa i perket çmimeve jonormalisht te uleta jane te dekajuara mire, te kjarta, si dhe shpjegimi te nderlidhja e pozicioneve per ekzekutimin e punimeve dhe mesatarja e çmimeve e nxjerrur ne ekzekutim te punimeve eshte mjaft bindes, duke ditur se ketu nuk kemi te bejme vetem me furnizim me gypa por furnizim dhe implementim ne ekzekutimin e punimeve, **andaj pergjigjet per Autoritetin Kontraktues Komuna e Skenderajt, kane qene mjaft bindese** si dhe gatishmeria e OE ekonomik per te rritur edhe Sigurimin e Ekzekutimit, prandaj duke ditur qe ***Autoriteti kontraktues vetë vlerëson nëse një tender është jonormalisht i ulët, si dhe e drejta dhe përgjegjësia bie mbi autoritetin kontraktues për të trajtuar një tender apo pozicion të tenderit si jonormalisht të ulët,*** *prandaj pas pergjigjeve te pranuara mjaft bindese AK- Skenderaj në harmoni të plotë me legjislacionin në fuqi rekomandon per shperblim me kontrate OE me çmimin me te lire te pergjegjshem* DESHISHKU GB SH.P.K.

Pra, AK për tej kërkesave ligjore, pa hulumtuar tregun dhe pa siguruar një provë apo fakt të argumentuar, madje edhe kërkesën me letër standarde për informata mbi tenderët jo normalisht te ulët e ka vetëm për disa pozicione dhe atë, pa kërkuar prova apo dëshmi të argumentuara, por mbështet vetëm me një dokument të OE në fjalë, e që dokumenti në fjalë nuk e ka arsyetimin bindes dhe të mbështetur me prova.

Provë 10: Dokumenti i sqarimeve nga OE "DESHISHKU GB" SHPK-PRISHTINË dhe kërkesa e AK.

Provë 11: Oferta –Deshishku- para masa e dorëzuar me rastin e ofertimit!

Madje, nga vet shkresa OE në fjalë dhe në dritën e kësaj shkrese, lehtësisht konstatohet se vet OE, të pozicioni 4.1.7, kostoja për ketë pozicion e thotë që është 14.00€, ndërsa çmimin për ketë pozicion ne paramasë e ka ofruar me 0.17€, pastaj pozicioni 4.2.4, kostoja 22.00€, ndërsa çmimin për ketë pozicion ne paramasë e ka ofruar me 0.12€, pozicioni 4.3.4, kostoja 6.20, ndërsa çmimin për ketë pozicion ne paramasë e ka ofruar me 0.14€.

Pra, referuar dokumentit të sqarimeve provës 10, vërtetohet se vet OE "DESHISHKU GB" SHPK-PRISHTINË, ka ofruar çmime manipulative, sepse kostoja e këtyre pozicioneve është shumëfish me lartë se sa çmimi i ofruar në ofertën financiare për AK dhe, rrjedhimisht sipas nenit 41 par 41.6 dhe 41.8 nen par a,b,c,d,e të Rregullores 01-2022, në rast se një tender (apo një pozicion i tenderit ku aplikohet çmimi i peshuar për njësi) duket të jetë jo normalisht i ulët dhe, nuk mund të arsyetohet me prova të argumentuara, konsiderohen çmime jo normalisht të ulëta ne kundërshtim me dispozitat e lartë cekura dhe ne kundërshtim me vet kërkesën e AK të paraparë në paramase, citojmë: Operatorët Ekonomik me Çmime Jo-normalisht të ulët do të eliminohen automatikisht gjatë procesit të vlerësimit të ofertave [.....]

Sepse, kur te aplikohet kriteri i vlerësimit Çmimin më te ulët me poentim, AK, nuk i din sasitë dhe nuk mund të aplikoj lidhshmërinë e pozicioneve, siç është munduar të arsyetoj OE"DESHISHKU GB" SHPK-PRISHTINË, sepse kjo nuk është ditur as nga ana e AK, për me tepër e shpërfaqe në sipërfaqe një anshmërinë e AK për të shpërblyer me kontratë OE në fjalë, ngase mundohet të arsyetoj ketë pretendim në rolin e Avokuesit të Kompanisë.

Madje, AK është ne kundërshtim me mendimin e eksperti shqyrtues dhe vendimin e panelit shqyrtues të

OSHP-se, nr.PSH 2023/0493, të vërejtura edhe nga eksperti shqyrtues dhe Paneli, se çmimet e tilla nuk korrespondojnë me çmime të tregut.

Çështje tjetër është fakti se, AK aplikon standarde të dyfishta, sepse nuk ka mundur të arsyetoj as vendimin nr. PSH, nr.2023/0545 të KK Skenderaj, si pretendim i yni i ngritur në kërkesën për rishqyrtim, një rast tjetër por që ka të bëje me çmime jo normalisht të ulëta, ku ne atë rast, vetëm për pozicionin "Gërshëre", për shkak të çmimit manipulativ e ka eliminuar OE nga aktiviteti i mëtejme, sepse Operatori nuk ka mundur të ofroj prova dhe fakte bindëse dhe te argumentuara.

Kurse ne ketë rast, AK pa hulumtuar tregun dhe pa pranuar as edhe një provë të argumentuar shpërblen me kontratë OE "DESHISHKU GB" SHPK-PRISHTINË, i cili ne shumicën e pozicioneve ka çmime manipulative, të cilat tashme janë trajtuar, ekzaminuar, krahasuar dhe vlerësuar në ankesën e me hershme të datës 17.07.2023, ne vendimin e OSHP-se, nr.PSH 2023/0493, dhe ri-kërkesën për rishqyrtim të datës 03.10.2023, të argumentuara me prova dhe dëshmi bindëse nga pro-faturat prodhuesve të gypave, për ato pozicione.

Duhet të theksohet se Neni 7, paragrafët 1, 2 dhe 4 i LPP-se, ndër të tjera, garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues të operatorëve ekonomik në procedurat e prokurimit publik, sepse i tërë qëllimi i normës së mësipërme është sigurimi i barabarësisë në trajtim të operatorëve ekonomik në mënyre barbaret dhe jo diskriminuese, ngase AK aplikon standarde të dyfishta nga rasti në rast.

Sjellim në vëmendje se barazia para ligjit është një prej te drejtave themelore të garantuar me nenet 3 dhe 24 të Kushtetutës. Më tutje, në bazë të Nenit 21, paragrafit 4 të Kushtetutës, këtë të drejtë kushtetuese e gëzojnë edhe personat juridik, duke përfshirë edhe kompanitë.

Barazia para ligjit, sipas interpretimeve gjyqësore, kërkon që personat (fizik dhe juridik) të kenë trajtim të njëllojtë, kur janë në rrethana të njëjta – siç janë operatorët ekonomik në rastin konkret.

Kështu, në linjë me rregullat ligjore të prokurimit, Operatori Ekonomik OE "DESHISHKU GB" SHPK-PRISHTINË do të duhej të trajtohej si operator i papërgjegjshëm në momentin qe, OE në fjalë nuk ka mundur të ofroj prova dhe dëshmi bindëse për AK, sepse Vendimi i OSHP-se, nr. PSH 2023/0493, nder të tjera kërkon, citojmë: ... atëherë vendos që AK gjatë fazës së ri-vlerësimit të bëjë vetë një hulumtim të tregut duke u bazuar në prova dhe fakte të argumentuara dhe konform nenit 59 të LPP të bëjë vlerësimin, krahasimin dhe ekzaminimin e të gjitha ofertave të përgjegjshme për këtë aktivitet të prokurimit.

Sidoqoftë, në asnjërën nga këto momente nuk u veprua konform legjislacionit në fuqi dhe vendimit të OSHP-së, kështu Operatori Ekonomik "DESHISHKU GB" SHPK-PRISHTINË, mbeti në garë edhe në procedurën e rivlerësimit, përveç se kësaj here tejet më i favorizuar se sa herën e parë. Për me tepër mbeti ne garë edhe GOE "IDEOR CONSTRUCTION"&"ISKOS TECH"& "IZO-H"& "VETONI", GOE të cilët janë konsideruar po ashtu me çmime manipulative, sepse edhe PSH ne vendimin nr. 2023/0493, ka vërejte se janë çmime manipulative.

Madje, GOE "IDEOR CONSTRUCTION"&"ISKOS TECH"& "IZO-H"& "VETONI", është i pa përgjegjshëm edhe sa i përket kritereve të përzgjedhjes të parapara në NJK dhe DT sepse nuk ka referenca për punë të ngjashme dhe nuk ka ne posedim Furgonin sipas kërkesave të AK, por AK qëllimshëm e lenë në garë.

Në vazhdën e kësaj, Autoriteti Kontraktues, nuk e ka respektuar vendimin e OSH-se, nr. PSH 2023/0493, sepse OE "DESHISHKU GB" SHPK-PRISHTINË dhe GOE "IDEOR CONSTRUCTION"&"ISKOS TECH"& "IZO-H"& "VETONI", kanë ofruar çmime manipulative dhe, rrjedhimisht në mbështetje të nenin Neni 105, par 2, nen par 2.16, kjo çështje është gjykuar "res judicata" sepse ka vendim meritor nga Paneli Shqyrtues i OSHP-së, ngase pretendimet dhe palët janë të njëjta, me që rast OSHP-ja me automatizëm duhet të lëshoj urdhërese për AK, sipas nenit 131 të LPP-së.

Meqenëse, tabelat e krahasimit me çmimet e tregut i kemi trajtuar edhe ne kërkesën e me hershme dhe ankese e dorëzuar në OSHP, prape edhe ne ketë ankese do ti paraqesim si prova dhe fakte te argumentuara.

Ne vijim do ti krahasojmë çmimet, të Pozicionit 4 të paramasës, te OE "DESHISHKU GB" shpk, i propozuar nga AK për kontratë dhe OE në radhë, Liderit të Grupit "Ideor Construction" shpk.

Çmimet e prezantuara në tabelë dhe të bashkangjitura ankesës në fund janë çmime të tregut për të cilat kemi hulumtuar dhe marrë çmime direkt nga Prodhuesit.

Krahasimi I cmimeve të OE të Propozuar për Kontratë dhe OE ne radhë me çmime të tregut						
Pozicioni 4.	"Furnizimi dhe montimi i gypave PE SN 8		Ofertat me çmime të Dy OE pjesmarres në kete aktivitet		Ofertat nga prodhuesit e gypave	
Nr.rend	Madhësia e gypit	Njësia	"DESHISHKU GB" shpk, cmimi njesi	IDEOR CONSTRUCTION SHPK", çmimet njësi	Oferta nga Prodhuesi "Fer Plast" Ferizaj	Oferta nga Prodhuesi "INOVA" Gjakovë
4.1.1	Ø 110	1m'	€ 0.11	€ 0.10	€ 1.65	€ 1.80
4.1.2	Ø 125	m'	€ 0.11	€ 0.20	€ 2.15	€ 2.20
4.1.3	Ø 160	m'	€ 0.12	€ 0.50	€ 2.90	€ 3.30
4.1.4	Ø 200	m'	€ 0.12	€ 1.00	€ 4.15	€ 4.10
4.1.5	Ø 250	m'	€ 0.14	€ 1.10	€ 6.30	€ 6.90
4.1.6	Ø 315	m'	€ 0.17	€ 1.20	€ 9.90	€ 9.75
4.1.7	Ø 400	m'	€ 0.17	€ 1.30	€ 15.90	
4.1.8	Ø 450	m'	€ 0.17	€ 1.40		
4.1.9	Ø 500	m'	€ 0.19	€ 1.50	€ 21.80	
4.1.10	Ø 600	m'	€ 0.19	€ 1.70	€ 40.00	
4.1.11	Ø 800	m'	€ 0.21	€ 4.90	€ 59.00	

Provë 12: Oferta nga : "FerPlast" Ferizaj, sipas profatures 299/23
Provë 13 : Oferta nga : "INOVA" SHPK, Gjakovë, ofr23-2-00011

Krahasimi I cmimeve të OE të Propozuar për Kontratë dhe OE ne radhë me çmime të tregut					
Pozicioni 4.3	"Furnizimi dhe montimi I gypave PVC për kyçjet e nevojshme me te gjitha pjeset fazonike te nevojshme per montimin e gypave ne vendet ku gypi është I demtuar"				
Nr.rend	Madhësia e gypit	Njësia	"DESHISHKU GB" shpk, cmimi njesi	IDEOR CONSTRUCTION SHPK", çmimet njësi	Oferta nga Prodhuesi "Bast trade" Obiliq
4.3.1	Ø 110	m'	€ 0.11	€ 0.10	€ 2.40
4.3.2	Ø 125	m'	€ 0.11	€ 0.20	€ 3.70
4.3.3	Ø 160	m'	€ 0.12	€ 1.00	€ 5.60
4.3.4	Ø 200	m'	€ 0.14	€ 1.05	€ 9.90

Provë 15: Oferta nga "Bast Trade", sipas pro faturës 290-1604/23

Pra, të gjitha këto prova të argumentuara i bëjnë të papërgjegjshëm të dy OE të cekur me lartë, për shkak se kanë manipuluar me çmime jo normale, çmime të cilat nuk janë çmime të tregut, për me tepër vet AK ka paraparë në paramase që Operatorët Ekonomik me Çmime Jo-normalisht të ulët do të eliminohen automatikisht gjatë procesit të vlerësimit të ofertave [.....].

Madje, përveç, këtyre pozicioneve për të cilat kemi dështmi të argumentuara që janë çmime jo normale dhe ne kundërshtim me dispozitat e nenit 61 par 1; 2 nen par 2.1& 2.2 të LPP-se dhe dispozitat e nenit 41 par 41.6 dhe 41.8 nen par a,b,c,d,e të Rregullores 01-2022, po ashtu të Dy OE të lartë cekuar kanë ofruar çmime manipulative edhe ne shumicën pozicioneve te paramases te cilat nuk janë përfshirë ne tabelat krahasuese, për me tepër referojuni paramases se ofertuar të "DESHISHKU GB" shpk, Prishtinë dhe GOE "IDEOR CONSTRUCTION"&"ISKOS TECH"& "IZO-H"& "VETONI", madje edhe ne kundërshtim të plotë me vërejtën-sugjerimin e AK të dhënë në paramasë-listë të çmimeve!

Vërejtja sipas AK parapare në fund të përshkrimit te çmimeve!.

	Vërejtje:			
1	Të gjitha çmimet e specifikuara në tender duhet të deklarohen në Euro (€). Çmimi i ofertuar lejohet që të shënohet me maksimum dy (2) numra pas presës dhjetore. Çdo numër i shënuar pas numrit të dyte (2) nuk do të merret për bazë në llogaritje të vlerës së ofertës., oferta e tillë do të konsiderohet e pa përgjegjëshme			
2	Në çmim të përfshihen të gjitha taksat e aplikuara në Kosovë			
3	Operatorët Ekonomik me Çmime Jo-normalisht të ulët do të eliminohen automatikisht gjatë procesit të vlerësimit të ofertave. OE të cilët do të vendosin çmimet njësi nuk duhet të vendosin çmime abnormalisht të ulëta të cilat nuk përkojn me çmimet e ofruara në treg pasi në të kundërt do të eleminohen automatikisht pa dhënë sqarime shtesë. Pagesat do të bëhën vetëm në bazë të punës së bëre nga AK (Detyrës Projektuese nga ana e Menaxherit të Kontratës. Detyra projektuese do ti përmbajë pozicionet e paramasës së mësipërme se cilat pozicione do të paguhen për projektin në fjalë)			

Prandaj, me te drejtë e kundërshtojmë vendimin e AK për refuzim të kërkesës për rishqyrtim sepse, është nxjerrë ne shkelje të dispozitave të lartë cekura dhe në shkelje të dispozitave të nen par (d), (h) dhe (o), të par 97.1 të nenit 97 të rregullores 01/2022, për shkak të mos respektimit dhe shkeljeve të parimeve themelore të prokurimit publik të përcaktuar me LPP dhe ne trajtim jo të barabartë të ofertuesve gjatë ushtrimit të procedurave të prokurimit, për shkak të mos respektimit të vendimeve të OSHP-së, si dhe për shkak të sjelljeve jo profesionale dhe të gabuara të zyrtarit të prokurimit, ngase që në shikim të parë oferta e OE në fjalë duken si jo të besueshëm nëse krahasohen me objektin e kontratës dhe në përputhje me rrethanat dhe që, ka gjasa për një ndikim negativ në performancë gjatë implementimit të kontratës për shkak të çmimeve manipulative!

Dhe, rrjedhimisht të gjitha pretendimet tona ankimore të lartë cekura dhe të argumentuara me prova e bëjnë te pa qëndrueshëm vendimin e AK për dhënie të kontratës dhe njoftimin për tenderuesin e suksesshëm të GOE "IDEOR CONSTRUCTION"&"ISKOS TECH"& "IZO-H"& "VETONI", sepse vendimi i AK është kundërshtim me të gjitha parimet themelore të LPP-se, sa i përket objektivitetit, integritetit, kompetencës profesionale, qëllimit, Ekonomiciteti dhe Efikasiteti.

Prandaj, mbi bazën e këtyre fakteve te lartë cekura, me të drejte e kundërshtojmë në tersi vendimin AK për refuzim të kërkese për ri-shqyrtim, sepse është nxjerrë ne shkelje të nenit 7, par 1;2 dhe 6; neni 59, par 2, neni 60 par 1, nen par 1.1, të LPP-se si dhe në shkelje të nenit par 41.1; 41.6;41.8 nen par a,b,c,d,e dhe par 41.9 nen par a. të RrPP 01/2022, sepse janë çmime jo normalisht të ultë dhe nuk janë relevante me aktivitetin e prokurimit!

Kurse, sa i përket njoftimit për tenderuesin e eleminuar (Letrën standarde për tenderuesin e eleminuar

B42) dhe Njoftimit te Vendimit B58 te AK për rezultatin e tenderit te datës 29.09.2023), qëndrojmë prapa kërkesës për rishqyrtim të dorëzuar në AK të cilën e kemi argumentuar dhe e cila është pjese e bashkangjitur në ketë ankesë, sepse vendimi i AK, është në kundërshtim të plotë me nenit 60, par 1, nen par 1.1, e LPP-se, sepse të dy ofertat janë të pa përgjegjshme, sepse kriter i vlerësimit ka qene Tenderi i përgjegjshëm me Çmimin më te ulët me poentim.

Dhe, rrjedhimisht, duke pasur parasysh se, jemi palë me interes juridiko material ne kuptim të nenit 4.1.26 të LPP-se, sepse jemi të përgjegjshëm dhe kemi ofruar çmimin me te ulët, kërkojmë nga OSHP-ja, që Ankesën të trajton në përputhje të plotë me dispozitat e LPP-se dhe rregulloreve në fuqi dhe argumenteve të prezantuara sepse ka tendencë për abuzim dhe keqpërdorim të buxhetit të Kosovës dhe Komunës në veçanti nga zyrtaret e AK KK Skenderaj.

Prandaj, duke u bazuar në faktet, argumentet, arsyetimet, provat materiale, kërkojmë nga Organi Shqyrtues i Prokurimit që, pas trajtimit të ankesës tonë të nxjerr:

VENDIM

Të nxjerrë vendim meritor me të cilin të aprovoj ANKESEN të bazuar të paraqitur nga N.T.SH. "KASTRATI-L" (LUIGJ KASTRATI B.I.) Drenas.

Te anuloj vendimin e AK – KUVENDI KOMUNAL SKENDERAJ, për refuzim të kërkesës për Ri-shqyrtim, sepse N.T.SH. "KASTRATI-L" (LUIGJ KASTRATI B.I.) Drenas, ka dorëzuar tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët;

Te kthej rastin ne Ri-Vlerësim dhe vlerësimi të behet me kërkesat dhe kriteret e përcaktuara në dosjen e tenderit dhe njoftimit për kontratë duke shpërblyer me kontratë operatorin ekonomik të përgjegjshëm që ka dorëzuar çmimin më të ulët në përputhje me kriteret vlerësimit N.T.SH. "KASTRATI-L" (LUIGJ KASTRATI B.I.)

Të lëshoj Urdhërese AK, për mos zbatim të vendimit të OSHP-se, PSH.nr. 2023/0493

Mbetemi me shpresë se Ankesa jonë do të shqyrtohet pozitivisht.

KRITERET PËR VLERËSIM

Ne vijim janë paraqitur kriteret e vlerësimit vetëm ato qe kanë te bëjnë me pretendimet ankimore.

Kërkesat; Kapaciteti teknik dhe profesional

a) 1 (një) inxhinier i diplomuar apo master drejtimi Hidroteknikë, me së paku 5 vite përvojë pune profesionale pas diplomimit.

b) 1 (një) inxhinier i diplomuar apo master drejtimi Infrastruktur Rrugore, me së paku 5 vite përvojë pune profesionale pas diplomimit.

c) 1 (një) inxhinier i diplomuar apo master drejtimi Gjeodezisë i licencuar me licensë valide me së paku 5 vite përvojë pune profesionale pas diplomimit.

d) 1 (një) inxhinier i diplomuar ose master, drejtimi Mbrojtje e Mjedisit, me së paku 5 vite përvojë pune profesionale pas diplomimit.

Operatori Ekonomik duhet te posedoje mjetet, stabilimentet dhe pajisjet teknike që janë te domosdoshme për realizimin e projektit, Paisjet dhe mekanizimi i obligueshëm sipas tabelës ne Aneksin 7 te DT.

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

Duke u bazuar në raportin e vlerësimit, komisioni vlerësues ka konstatuar si në vijim:

Grup i Operatorëve Ekonomik REKA E MADHE SH.P.K.; V - SHALA SH.P.K.; MIRUSHA COMPANY SH.P.K.; IDEALI COMPANY SH.P.K. me qmimin me te qmimi ofertues i peshuar 51.57 EUR, ka qmimin me te ulet te peshuar, por ketij grupi te OE i mungojnë dokumentacioni te stafi profesional (ingjinieri i infrastruktures rrugore, ka mosperputhje te CV-së, inxhinierja Doruntina Bytyqi ka pervojë vetem 2 vite e 3 muaj e dy ditë pas diplomimit, derisa ne DT kerkohet qe inxhinieri duhet te kete minimum 5 vite pervoje pune pas diplomimit). Perveq kesaj Inxhinierja ne fjalë, ka te kryer drejtimin Infrastrukturë transporti e cila nuk korrespondon me kriterin ne DT (Inxhinier per Infrastrukturë Rrugore). • OE DESHISHKU GB SH.P.K., qmimi ofertues 61.62 EUR qe është i dyti me qmimin me te ulet te peshuar ka perhstatshmeri profesionale sipas DT OE Luigj Kastrati B.I. pika b) 1 (nje) inxhinier i diplomuar apo master drejtimi Infrastruktur Rrugore, me se paku 5 vite pervoje pune profesionale pas diplomimit. Ndersa, inxhineri i prezentuar ne oferten tuaj per Infrastruktur Rrugore, Faton Kastrati, ka diplomuar me date: 13.06.2018 dhe nuk e ploteson pervojen e punes prej min. 5 viteve pas diplomit, sepse pervoja e punes pas diplomit ne CV e tij, shenon nga data:01. Shkurt 2021- Prezent, qe i bie 2 vite e 2 muaj pervoje pune profesionale si inxhinier i diplomuar per Infrastrukture Rrugore.
1 (një) inxhinier i diplomuar apo master drejtimi Gjeodezisë i licencuar me licensë valide me së paku 5 vite përvojë pune profesionale pas diplomimit. Inxhinierit të Gjeodezisë i prezantuar në ofertën tuaj, Fidan Hasaj, i mungon Licensa e Gjeodetit.
1 (një) inxhinier i diplomuar ose master, drejtimi Mbrojtje e Mjedisit, me së paku 5 vite përvojë pune profesionale pas diplomimit. Inxhinieri i prezentuar në ofertën tuaj, Vehbi Spahiu, nuk e ka të në nënshkruar fare CV- e tij,

Grupi i Operatorëve Ekonomik REKA E MADHE SH.P.K.; V - SHALA SH.P.K.; MIRUSHA COMPANY SH.P.K.; IDEALI COM SH.P.K. me qmimin me te qmimi ofertues i peshuar 51.57 EUR, ka qmimin me te ulet te peshuar, por ketij grupi te OE i mungojnë dokumentacioni te stafi profesional (ingjinieri i infrastruktures rrugore, ka mosperputhje te CV-së, inxhinierja Doruntina Bytyqi ka p 2 vite e 3 muaj e dy ditë pas diplomimit, derisa ne DT kerkohet qe inxhinieri duhet te kete minimum 5 vite pervoje pune pas diplomi kesaj Inxhinierja ne fjalë, ka te kryer drejtimin Infrastrukturë transporti e cila nuk korrespondon me kriterin ne DT (Inxhinier per Inf Rrugore). • OE DESHISHKU GB SH.P.K., qmimi ofertues 61.62 EUR qe është i dyti me qmimin me te ulet te peshuar ka perhs profesionale sipas DT

OE Luigj Kastrati B.I. pika b) 1 (nje) inxhinier i diplomuar apo master drejtimi Infrastruktur Rrugore, me se paku 5 vite pervoje pu profesionale pas diplomimit. Ndersa, inxhineri i prezentuar ne oferten tuaj per Infrastruktur Rrugore, Faton Kastrati, ka diplomuar m 13.06.2018 dhe nuk e ploteson pervojen e punes prej min. 5 viteve pas diplomit, sepse pervoja e punes pas diplomit ne CV e tij, shen data:01. Shkurt 2021- Prezent, qe i bie 2 vite e 2 muaj pervoje pune profesionale si inxhinier i diplomuar per Infrastrukture Rrugore. 1 (një) inxhinier i diplomuar apo master drejtimi Gjeodezisë i licencuar me licensë valide me së paku 5 vite përvojë pune profesional diplomimit. Inxhinierit të Gjeodezisë i prezantuar në ofertën tuaj, Fidan Hasaj, i mungon Licensa e Gjeodetit.

1 (një) inxhinier i diplomuar ose master, drejtimi Mbrojtje e Mjedisit, me së paku 5 vite përvojë pune profesionale pas diplomimit. In prezentuar në ofertën tuaj, Vehbi Spahiu, nuk e ka të në nënshkruar fare CV- e tij,

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

Me datë 30.10.2023 permes emailit kemi kërkuar sqarimet shtesë tek AK-Komuna e Skenderaj dhe me datën

03.11.2023 KK Skenderaj na ka dërguar raportin e hulumtimi, te cilin me gjerësisht do te trajtojm tek pjesa e përgjigjeve ne pretendimet ankimore.

Emaili i dërguar, shih print screen:

Kërkesë per Sqarime Shtesë » Inbox ×

Gani Nekaj <ganinekaj@gmail.com>
to Haxhi.bejta

Mon, Oct 30, 4:07 PM (7 days ago)

Te nderuar,

Unë jam Gani Nekaj- Ekspert Shqyrtues i jashtëm i OSHP-se dhe njeherit i autorizuar me autorizim nga OSHP nr. 2023/0783 për trajtimin e RI Ankesës te datës 11.10.2023, nr. 2023/0783 të bërë nga OE NTSH Kastrati -L (Luigj Kastrati B.I) për aktivitetin e prokurimit 044 - **Mirëmbajtja e rrjetit të kanalizimeve brenda territorit të komunës së Skenderajt me nr prokurimi 643-23-5477-5-2-1.**

Kërkojmë nga AK-Komuna e Skenderajt qe te na dërgoj sqarimet si ne vijim:

- Sipas vendimit te OSHP-se te datës 07.09.2023 nder te tjera kërkohet qe AK-Komuna e Skenderaj gjatë rivlerësimit te ofertave te bëjë një hulumtim te tregu duke u bazuar ne fakte dhe prova te argumentuara dhe konform nenit 59 te bëjë vlerësimin, krahasimin dhe ekzaminimin e te gjitha ofertave te përgjegjshme për këtë aktivitet te prokurimit.

Kërkojmë nga AK-Komuna e Skenderaj te na njoftoj nëse ka bërë një hulumtim te çmimeve te tregut sipas vendimit te OSHP-se te datës 07.09.2023 dhe nëse PO atëherë te na i dërgoni faktet dhe provat e argumentuara për këtë hulumtim tregu.

Te gjitha faktet dhe provat për këtë hulumtim tregu sipas vendimit te OSHP-se te datës 07.09.2023 na i dërgoni me se largu deri me dt.03.11.2023.

Paraprakisht ju falënderoj për bashkëpunimin.

Email i pranuar nga KK Skenderaj me dt 03.11.2023.

Kërkesë per Sqarime Shtesë Inbox ×

Gani Nekaj <ganinekaj@gmail.com>
to Haxhi.bejta

Mon, Oct 30, 4:07 PM (7 days ago)

Te nderuar,

Unë jam Gani Nekaj- Ekspert Shqyrtues i jashtëm i OSHP-se dhe njeherit i autorizuar me autorizim nga OSHP nr. 2023/0783 për trajtimin e RI Ankesës te datës 11.10.2023, nr. 2023/0783 të bërë nga OE NTSH Kastrati -L (Luigj Kastrati B.I) për aktivitetin e prokurimit 044 - **Mirëmbajtja e rrjetit të kanalizimeve brenda territorit të komunës së Skenderajt me nr prokurimi 643-23-5477-5-2-1.**

Kërkojmë nga AK-Komuna e Skenderajt qe te na dërgoj sqarimet si ne vijim:

- Sipas vendimit te OSHP-se te datës 07.09.2023 nder te tjera kërkohet qe AK-Komuna e Skenderaj gjatë rivlerësimit te ofertave te bëjë një hulumtim te tregu duke u bazuar ne fakte dhe prova te argumentuara dhe konform nenit 59 te bëjë vlerësimin, krahasimin dhe ekzaminimin e te gjitha ofertave te përgjegjshme për ketë aktivitet te prokurimit.

Kërkojmë nga AK-Komuna e Skenderaj te na njoftoj nëse ka bërë një hulumtim te çmimeve te tregut sipas vendimit te OSHP-se te datës 07.09.2023 dhe nëse PO atëherë te na i dërgoni faktet dhe provat e argumentuara për ketë hulumtim tregu.

Te gjitha faktet dhe provat për ketë hulumtim tregu sipas vendimit te OSHP-se te datës 07.09.2023 na i dërgoni me se largu deri me dt.03.11.2023.

Paraprakisht ju falënderoj për bashkëpunimin.

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

Ne mbështetje te nenit 4.1.26 konstatojmë se OE **Ankues.** ne cilësinë e operatorit ekonomik ankues është palë me interes.

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

Ekspertize nr. 2023-0493 _08.08.2023

Vendim i panellit shqyrtues nr 2023-0493_07.09.2023

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **Luigj Kastrati B.I.**

Përgjigje në pretendimi nr.1.

Sqarim:

Ne ankesën e dt. 15.07.2023 nr 2023-0493 te bërë nga OE ankues per rastin e njejtë ky pretendim ankimor ka qenë i renditur nr 2.

Pretendimi ankimor nr.1 se operatori ekonomik ankues nuk ka plotësuar kërkesen e dosjes se tenderit dhe NJK ne plotësim te kërkesës III.2.4 Kapaciteti Teknik dhe profesional , pika b, ku është kërkuar inxhinier i diplomuar apo master drejtimi infrastrukturor rrugor, me se paku 5 vite përvojë pune profesionale pas diplomimit.

Sipas AK-Komuna e Skenderajt , inxhinier i prezentuar ne ofertën e OE ankues Z. Faton Kastrati, nuk e plotëson përvojën e punës sipas kërkesës se dosjes se tenderit sepse ne CV-në e tij shkruan përvoja e punës 01. Shkurt 2021-prezent.

Eksperti shqyrtues bazuar ne CV-në e inxhinierit konstaton se ne CV ka te paraqitura edhe punë tjera qe ky inxhinier ka kryer edhe para dt. 01 Shkurt 2021 dhe po ashtu nëse marrim per bazë dt. e diplomimit te tij me 13.06.2018 dhe dt. e hapjes se ofertave 19.06.2023 plotësohet kërkesa e dosjes se tenderit. Është në përgjegjësin e AK-Komuna Skenderaj nëse do te i verfifikoj apo sqaroj CV-në përkatëse sipas nenit 72 te LPP-së, nenit 10.1 te Udhezuesit 001/2023.

Bazuar ne shkresat e lëndes dhe kërkesat e dosjes se tenderit, CV-ne ofruar nga OE ankues per inxhinierin ne perkates konstatojmë se ky pretendim ankimor është **i Bazuar.**

Përgjigje në pretendimi nr.2

Ky pretendim ankimor nuk ka qenë i paraqitur ne ankesën te dt. 15.07.2023 nr 2023-0493.

Sa i perkt pretendimit ankimor nr 2 se OE ankues nuk ka përmbushur piken III. 2.4 te Kapacitetit teknik dhe profesional pika c), sipas AK-KK Skenderaj operatori ekonomik ankues nuk ka plotësuar ketë kërkesë sepse Inxinieri i Gjeodezisë i prezentuar ne ofertën e OE ankues, i mungon Licenca e Gjeodezisë.

Eksperti shqyrtues ne lidhje me ketë pikë konstaton se ne CV e gjedotetit Fidan Hasaj shkruan se është i licensuar nga viti 2011.

Gjeodet i Licencuar

Gjeodet i licencuar për matje Kadastrale dhe Gjeodezike, Licenca nr.90

11.02.2011 – e në vazhdim

Licencë personale nga Agjencioni Kadastral i Kosovës

Ne lidhje me ketë pikë rekomandojm qe AK-Komuna Skenderaj te trajtoj ketë pikë sipas nenit 72 te LPP-së, nenit 10.1 te Udhezuesit 001/2023.

Mungon licenca	Mund të kërkohen informata sqaruese

Bazuar ne shkresat e lëndes dhe kërkesat e dosjes se tenderit, konstatojmë se ky pretendim ankimor është **pjesërishti bazuar.**

Përgjigje në pretendimi nr.3

Ky pretendim ankimor nuk ka qenë i paraqitur ne ankesën te dt. 15.07.2023 nr 2023-0493.

Sa i perkt pretendimi ankimor nr 3 se OE ankues nuk ka përmbushur piken III. 2.4 te Kapacitetit teknik dhe profesional pika d), sipas AK-KK Skenderaj operatori ekonomik ankues nuk ka plotësuar ketë kërkesë sepse inxhinieri i diplomuar apo master i mjedisit nuk ka z. Vehbi Spahiu , nuk ka te nënshkruar CV.

Ne lidhje me ketë pikë rekomandojm qe AK-Komuna Skenderaj te trajtoj ketë pikë sipas nenit 72 te LPP-së, nenit 10.1 te Udhezuesit 001/2023, dhe te konstatohet nëse inxhinier përkatës qëndron prapa CV-se se tij.

CV-ja e dorëzuar nuk përmban informatat e kërkuara, AK nuk mund të vendos	Mund të kërkohen informata sqaruese	69

Bazuar ne shkresat e lëndes, kërkesat e dosjes se tenderit, ofertën e operatorit ekonomik konstatojmë se ky pretendim ankimor është **pjesërishti bazuar.**

Përgjigje në pretendimi nr.4

Ky pretendim ankimor nuk ka qenë i paraqitur ne ankesën te dt. 15.07.2023 nr 2023-0493.

Sipas AK-KK Skenderaj operatori ekonomik ankues nuk ka përmbushur kërkesen e dosjes se tenderit saktësisht ankesin 7 te DT. Sipas AK-KK Skenderaj OE ankues nuk ka prezentuar ne ofertën e tij Kamion Kiper me dy dyer nr targa: 01-735-SF, librezën me validitet te rexhistrimit te skaduar.

Dëshmia e kerkuar nga autoriteti kontraktues ne dosje te tenderit ne lidhje me ketë kërkesë nuk është e çartë sepse edhe vet autoriteti ka bërë nje formulim te tillë tek dëshmia e kërkuar "**Dëshmi mbi pronësinë (apo marrëveshje të marrjes me qira) të mjeteve, librezat e qarkullimit, ndërsa per ato mjete që nuk kanë libreza të qarkullimit. d Deklaratat unike doganore apo fatura. Vëmendje! Ne rast se OE nuk posedon pajisjet mbi pronësinë duhet te ofroj marrëveshjen për marrjen me qira të pajisjeve. Marrëveshja duhet të jetë në emër të këtij projekti me validitet të kohëzgjatjes të kësaj kontrate e nënshkruar dhe vulosur nga te dyja palët.**

Nga kjo shihet se AK kërkon librezat e qarkullimit ndërsa përkundër faktit qe e ka shkruar nuk e ka te sqaruar se si do te veprohet per ato mjete qe nuk kanë libreza te qarkullimit.

Bazuar ne kontraten ne mes te OE ankues dhe kompanis ISEFERI rezulton se kontrata është per 3 kamion kiper 10-17 tonë, referoju nenit 2 te kontartes saktësisht pikës 2.2.

Bazuar ne shkresat e lëndes , kërkesat e dosjes se tenderit, oferten ofruar nga OE ankues dhe kontratën ne mes te OE ankues dhe OE I SEFERI , konstatojmë se ky pretendim ankimor është **i Bazuar.**

Përgjigje në pretendimi nr.5

Sa i përket pretenimit ankimor nr 5, sipas te cilit AK-KK Skenderaj thekson se operatori ekonomik nuk ka përmbushur kërkesen sepse ka mospërputhje te dukshme ne nënshkrimin e CV-së se inxhinierit ne drejtimin Hidroteknikë z. Ilazi Muhaxheri.

Eksperti shqyrtues rekomandon qe AK-KK Skenderaj te bejë sqarimin e kësaj kërkese nëse ka dyshime te caktuara. Ne lidhje me ketë pikë rekomandojm qe AK-Komuna Skenderaj te trajtoj ketë pikë sipas nenit 72 te LPP-së, nenit 10.1 te Udhezuesit 001/2023, dhe te konstatohet nëse inxhinieri përkatës qëndron prapa CV-së së tij dhe nënshkrimeve te tij dhe te konstatohet nëse dokumenti ne fjalë i paraqitur ne ketë tender është me dijenin te personit përkatës (inxhinierit te Hidorteknike).

Bazuar ne shkresat e lëndes, kërkesat e dosjes se tenderit, ofertën e operatorit ekonomk konstatojmë se ky pretendim ankimor është **pjesërisht i bazuar.**

Përgjigje në pretendimi nr.6

Ne ankesën e dt. 15.07.2023 nr 2023-0493 te bërë nga OE ankues per rastin e njejtë ky pretendim ankimor ka qenë i renditur nr 1.

Ky pretendim ankimor i paraqitur ne ankesën e operatorit ekonomik ankues ne lidhje me mbetjen ne fuqi te vendimit te AK B58 mbi dhënien e kontratës se OE Deshishku shpk, Prishtinë, i cili ka te bejë me shkelje te nenit 61 te LPP-së Tenderet Jo-normalisht te ulë, paragrafi 1,2 nen paragrafi 2.1,2.2,2.3 dhe 2.4 dhe dispozitat e nenit 41 te Rregullores per Prokurim Publik 001/2022 , ky pretendim ankimor është trajtuar edhe ne raportin e ekspertit shqyrtues te dt. 08.08.2023 sipas te cilit "**Bazuar ne argumentet dhe faktet qe ka prezantuar OE ankues ky pretendim ankimor ne parim është i bazuar pasi qe sipas nenit 41. 6 dhe 8 te Rregullores për prokurim publik 01/2022 AK ka pas për obligim qe ta trajtoj ofertën e OE të rekomanduar por edhe operatorëve tjerë qe konsiderohen te suksesshëm që kane ofruar oferta me çmime abnormalisht te ulëta".**

Eksperti shqyrtues konstaton se ky pretendim ankimor është trajtuar ne raportin e ekspertit me dt. 08.08.2023 dhe ne Vendimin e Panellit te OSHP-se te dt. 07.09.2023 dhe si rrjedhoj nuk ka nevoj te trajtohet përsëri pasi qe kemi te bëjmë me pretendimin e njejtë ankimor.

Panelli shqyrtues përmes vendimit te dt.07.09.2023 nr 2023-0493 ka kërkuar qe AK-Komuna e Skenderaj gjatë rivlerësimit te ofertave te bëjë një hulumtim te tregu duke u bazuar ne fakte dhe prova te argumentuara dhe konform nenit 59 te bëjë vlerësimin, krahasimin dhe ekzaminimin e te gjitha ofertave te përgjegjshme për ketë aktivitet te prokurimit.

AK-Komuna Skenderaj gjatë fazës se rivlerësimit sipas sqarimeve shtesë qe kemi kërkuar rezulton qe ka bërë hulumtim tregu dhe me datë 26.09.2023 ka përgatitur raportin mbi hulumtimin e tregut.

Nga hulumtim i tregut shihet se janë marrë nga AK-Komuna Skenderaj ofertat nga 3 operator ekonomik dhe rezulton se OE Ankues ka ne disa pozicione çmime te larta mbi mesataren e tregut te hulumtuara nga KK Skenderaj dhe te paraqitura përmes raportit te dt. 26.09.2023. Hulumti i tregut mbetet në përgjegjësin e AK-Komuna e Skenderaj nëse janë përdorur metodat me te mira te hulumtimit te tregut ne harmoni me qellimin e aktivitetit te prokurimit.

Bazuar ne aneks dokumentin i cili do te i bashkangjitet këtij raporti konstatojmë se disa çmime janë shumë me te larta se mestarja e hulumtimit te tregut dhe disa janë shumë me te ulëta se mesatarja e çmimeve te tregut. Po ashtu kemi nje ndryshim te madh te disa çmimeve ne mes te hulumtimit te tregut të bërë nga OE ankues dhe KK Skenderaj.

Operarotori ekonomik ankues ka çmime te larta ne krahasim me te gjithë ofertuesit tjerë, konstatim i cili është trajtuar nga eksperti shqyrtues edhe ne raportin e dt.08.08.2023, dhe cila shihet edhe përmes çmimeve te paraqitura ne procesverbalin e hapjes.

Po ashtu konstatojm se OE Ankues ka çmime te larta mbi mesataren ne disa pozicione te hulumtimit te tregut te bërë nga KK Skenderaj ndërsa edhe OE i rekomanduar per kontratë ka ne këto pozicione çmime jo normalisht te ulëta në krashim me mesataren e çmimeve te hulumtimit te bërë nga AK Komuna Skenderaj.

Nr.	Poz. dhe përshkrimi	Çmimi i OE Ankues €	Çmimi mesatar ne bazë te hulumitmit të bërë nga AK Komuna Skenderaj
1	1.4 Kontrollimi dhe evidentimi i instalimeve nëntokësore, zgjedhja e problemeve eventuale që lidhen me planin operativ të ndërtimit si dhe përpilimi i planit detal operativ që lidhet më procesin e ndërtimit. Në çmim të llogaritet edhe kosto eventuale e detektimit me aparatura elektronike për instalime nëntokësore si dhe evidentimi i saktë i instalimeve që duhet të	59.00	2.18€

	mirëmbahen gjatë kohës se ndërtimit dhe ne rast demtimi te behet riparimi i tyre (rrjeti elektrik, ujesjellesit, rrjetit kabllor, rrjeti i telefonisë, etj)		
2			
	4.2.1 Ø 200	14.16	7.00
	4.2.2 Ø 400	18.88	11.00
	4.2.3 Ø 500	25.96	13.27
	4.2.4 Ø 600	27.14	16.33
	4.2.5 Ø 800	29.50	19.10

Çmimet e tilla janë te bazuara ne hulumtimin e çmimeve te tregut të bëra nga AK Komuna e Skenderaj.

Me gjerësisht referoju aneks raportit te bashkangjitur.

Nga raporti i hulumtimit i bërë nga AK Komuna Skenderaj, çmimet per njësi te OE te rekomandur per kontratë dhe çmimet per njësi te OE ankues rezulton se kemi nje dallim te madh te çmimeve ne disa pozicione dhe si rrjedhoj e kësaj ne parim këta tender duhet te trajtohen sipas nenit 41.1 i cili thotë:

Neni 41 i Rregullores per Prokurim Publik

Tenderët Jo-normalisht të Ulët

41.1 Koncepti i tenderit jo-normalisht të ulët i referohet tenderëve që për autoritetin kontraktues në shikim të pare duken si jo të besueshëm nëse krahasohet me objektin e kontratës dhe në përputhje me rrethanat, dhe që ka gjasa për një ndikim negativ në performancë të implementimit të kontratës.

Dhënia e nje kontratë me çmime me tilla te njësive me ndryshime te mëdha ne disa pozicione ka gjasa për një ndikim negativ në performancë të implementimit të kontratës.

AK-Komuna Skenderaj përmes përdorimit te kriterit te dhënies "Tenderi i përgjegjshëm me **Çmimin më te ulët i peshuar (poentuar)"** nuk ka arritur te siguroj ofertën me te favorshme me çmime te tregut.

Bazuar ne përshkrimin e bërë me sipër sipas shkresave te lëndes, hulumtimit te tregut te berë nga AK Komuna e Skenderaj te dt. 26.09.2023, raportit te vlerësimit, dosjes se tenderit, pretendimeve ankimore te ankuesit, eksperti shqyrtues rekomandon panellin shqyrtues qe te anulohet Vendimi i AK-së i datës 29.09.2023 mbi dhënie e kontrates dhe te anulohet në tërësi njoftimi per kontratë.

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues:

- Ankesa e Operatorit Ekonomik ankues **OE "Luigj Kastrati B.I.**" është **pjesërisht e BAZUAR**

- Të anulohet **NJOFTIMI MBI VENDIMIN E AK-së** i datës 29.09.2023 mbi njoftimin per dhënie te kontrates

- Te Anulohet njoftimi per kontratë

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet pjeserisht si e bazuar, të anulohet njoftimit për kontratë dhe nëse AK më tutje ka interes, aktivitetin e prokurimit ta ritenderojë.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **K.K. SKENDERAJ**
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – **Luigj Kastrati B.I.**

REPUBLIKA E KOSOVËS
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
PRISHTINË/A
REPUBLIKA KOSOVA

Gani Nekaj